REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS
FINANCA

Has,me 30/03/2026

Lënda: Relacion "Mbi përdorimin e fondit për projektin "Shërbim Levizes i specializuar- PAK Plus" me financim të përbashkët nga Fondi Social i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Bashkisë Has"

Bazuar në, Ligjin Nr.139/2015, date 17.12.2015 "Për Veteqeverisjen Vendore", Ligjin Nr.68/2017 "Per Financat e Veteqeverisjes Vendore", Ligjin Nr.9936, date 26.06.2008 "Per Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republiken e Shqiperise" i ndryshuar, Udhëzimit Plotësues Nr.2 datë 14.01.2026 "Për zbatimin e buxhetit 2026":

Ky projektvendim ka për qëllim **përdorimin dhe rishpërndarjen e fondeve buxhetore** në funksion të zbatimit të projektit "Shërbim Lëvizës i Specializuar – PAK Plus", i cili financohet në mënyrë të përbashkët nga **Fondi Social i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale** dhe Bashkia Has.

Qëllimi kryesor është:

- Sigurimi i fondeve për **pagat dhe sigurimet shoqërore** të stafit që do të angazhohet në projekt;
- Garantimi i zbatimit të projektit në përputhje me standardet e shërbimeve sociale;
- Rritja e cilësisë së shërbimeve për personat në nevojë, veçanërisht për kategoritë përfituese të projektit PAK Plus.

1. **Miratimin e përdorimit të fondit** për financimin e stafit të projektit, konkretisht:
    - Drejtor Projekti
    - Punonjësit Social
    - Shofer
    - Fizioterapist
    - Logopedist
2. **Mbështetjen financiare për paga dhe sigurime shoqërore,** sipas strukturës së miratuar të projektit.

➢ Pika 2 e PV parashikon rishpërndarjen e fondeve brenda buxhetit te planifikuar per vitin 2026, si më poshtë:
    - Pakësim i fondit social llogaria 606 në vlerën 2,000,000 lekë;
    - Shtim në zërin:
        - Paga 600: 1,460,680 lekë
        - sigurime shoqërore 601: 539,320 lekë

Për sa më sipër, kërkohet miratimi i projektvendimit nga Këshilli Bashkiak.

Konceptoi:
Grislanda Bajraktari

Adresa: Sheshi "Dëshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, Email:info@bashkiahas.gov.al.